

NewsLetter 20 Years



THE OFFICIAL NEWSLETTER OF THE AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE IN ALBANIA

OPINION EKONOMIK

TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI



Mark Crawford
Aksioner ISB

Dy muaj më parë unë dhashë një intervistë publike ku thuhej se situata e tregjeve të kapitalit në Shqipëri është e ngjashme me një stadium të ri futbolli, plot me lojtarë, gjyqtarë dhe tifozë, por pa top për të luajtur. Shqipëria ka shpenzuar miliona dollarë gjatë tre dekadave të fundit për të vendosur rregullat e lojës në legjislacion, për të zhvilluar Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare që te referojë sektorin, duke licencuar disa aktorë në treg, përfshirë dhe firmën time Aksioner ISB. Ka shqiptarë dhe ndërkombëtarë që kanë interes për të investuar kapital ketu përmes një strukture lokale të tregut të kapitalit; sidoqoftë, nuk ka asnjë ekuitet ose borxh të shënuar, përveç bonove të thesarit. Në tregun e Bonove të Thesarit mbizotërojnë bankat, gjë që është normale. Pa asnjë obligacion ose ekuitet të listuar, është sikur skuadrat, tifozët dhe gjyqtarët janë mbledhur për një ndeshje futbolli pa top. Problemi nuk është rishikimi i rregullave, ose riorganizimi i lojtarëve, apo edhe lëshimi ose revokimi i licencave. Problemi është gjetja e një topi me të cilin mund të luhet ndeshja.

Në rajon, shumica e qeverive morën një vendim strategjik për të përdorur tregjet e kapitalit në privatizimin e një numri ndërmarrjesh në pronësi shtetërore, pjesërisht ose tërësisht. Shqipëria mori një vendim të vetëdijshëm...

» Vizion në faqen 4

PASURITË E FSHEHURA

AmCham Prezanton Edicionin e 8-të të INDEXIT të BIZNESIT për Vitin 2019 - 2020

Në faqen 2



EFEKTET E COVID-19

Ekonomia po shkon drejt rënies më të madhe që nga 1997-a

COVID 19- ECONOMIC NEWS

Në faqen 5

Tremujori i parë i vitit 2020 ka sinjalizuar rënien më të fortë ekonomike që vendi ka përjetuar të paktën në dy dekadat e fundit. Goditja e dyfishtë nga tërmeti i 26 nëntorit

dhe izolimi i ekonomisë për shkak të Covid në gysmën e muajit mars sollën një rezultat negativ në -2.52% në janar-mars 2020. Ky tremujor përfaqëson rënien më të madhe që kur ka nisur të matet...



AmCham Prezanton Edicionin e 8-të të Indexit të Biznesit për Vitin 2019 - 2020

Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri (AmCham) ka prezantuar Edicionin e 8-të të Indeksit të Biznesit për vitin 2019-2020, në konferencën me temë: "Rritja Ekonomike Fillon me Klimën e Biznesit". Të pranishëm në panel, për të adresuar gjetjet e raportit dhe diskutuar mbi sfidat e klimës së biznesit në Shqipëri ishin, Ministri i Mbrojtjes së Sipërmarrjes, z. Eduard Shalsi, Ambasadorja e SHBA-ve në Tiranë, Shkëlqesia e Saj, znj. Juri Kim, Drejtori i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, z. Matteo Colangeli, Përgjegjësjja për Politikat Ekonomike në Partinë Demokratike, znj. Jorida Tabaku, Presidenti i Dhomës Amerikane, z. Enio Jaço dhe Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Amerikane, z. Ilir Trim.

Indeksi i Biznesit i Dhomës Amerikane për vitin 2019 ka zbritur në 38 pikë nga 100 të mundshme duke reflektuar një rënie prej 4.98 nga një vit më parë. Gjetjet e Indexit u bënë publike nga Presidenti i Dhomës Amerikane, z. Enio Jaço. Gjatë prezantimit të rezultatit të sondazhit, z. Jaço bëri

Gjatë prezantimit të rezultatit të sondazhit, z. Jaço bëri të ditur se **66% e anëtarëve të Dhomës Amerikane e perceptojnë klimën e biznesit në Shqipëri në vitin 2019 si të pafavorshme** ose shumë të pafavorshme, 7% e anëtarëve e konsideruan atë si pozitive dhe 26% neutrale.

të ditur se **66%** e anëtarëve të Dhomës Amerikane e perceptojnë klimën e biznesit në Shqipëri në vitin 2019 si **të pafavorshme** ose shumë të pafavorshme, **7%** e anëtarëve e konsideruan atë si pozitive dhe **26%** neutrale.

RRETH INDEXIT TË BIZNESIT TË AMCHAM PËR VITIN 2019

Indeksi i Biznesit 2019-2020 ka sjellë opinionin dhe vlerësimin e anëtarëve të AmCham-it, duke reflektuar shqetësime të thella për disa nga parametrat themelore të klimës. Si rezultat, Indeksi i Biznesit shënoi një

ulje me (-4.99) pikë, duke zbritur për 2019-ën në 38.17 nga 43.16 që ishte në 2018-ën.

Duke analizuar në detaje indikatorët e Indeksit të Biznesit, perceptimi i anëtarëve të AmCham-it për indikatorin "Klima e Biznesit" ka shënuar një rënie të dukshme prej (-10.35) pikë në krahasim me 2018-ën, duke zbritur në 30.24 nga 40.58 dhe duke përbërë kështu indikatorin me uljen më të ndjeshme. Negative kanë qenë perceptimet e të anketuarve edhe për "Klimën e Brendshme Politike", e cila ka shënuar një ulje prej (-7.68) pikësh. Megjithatë

anëtarët e anketuar të AmCham-it kanë vazhduar të perceptojnë një rënie në "Performancën e Ekonomisë Shqiptare" (-6.32) pikë, analiza më e detajuar e këtij indikatorit ka treguar se shumica e tyre, kanë ruajtur ose rritur investimet dhe punësimin në 2019-ën. Të pakënaqur janë shfaqur anëtarët e AmCham-it edhe për sa i takon "Reformave dhe Politikave Ekonomike të Qeverisë", që është vlerësuar me një ulje prej (-6.07) pikë, ndërkohë që "Niveli i Korrupsionit" ka marrë një vlerësim negativ duke shënuar një ulje me (-5.90) pikë.

Kanë vazhduar të konceptohen në 2019-ën si problematika të vazhdueshme dhe të pazgjidhura, edhe indikatorë si "Monopoli dhe Konkurrenca e Padrejtë" me një rënie prej (-2.55) pikë, "Niveli i Ekonomisë Joformale" me (-4.54) pikë, apo dhe "Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve" me (-5.04) pikë.

Ndërkaq, anëtarët e AmCham-it kanë reflektuar një perceptim të qëndrueshëm për sa i takon indikatorit të "Niveli i Përgjithshëm i Taksave" (+0.07) pikë dhe një vlerësim pozitiv për lidhjen e tyre me autoritetet doganore me (+2.12) pikë dhe autoritetet tatimore me (+0.36) pikë.

Z. ENIO JACO

Presidenti i AmCham



“Rezultatet e Index-it të 2019 nuk janë të mira. Kjo duhet të na vendosë të gjithëve në një situatë urgjence për ta përmirësuar situatën. Post-COVID-19 nuk është një situatë e zakonshme dhe si kërcënimi ashtu dhe oportuniteti janë shumë të mëdha për t’u injoruar. Që të përfitojmë nga ky moment duhet të punojmë së bashku. Në radhë të parë sektori privat dhe administrata publike, forcat politike dhe partnerët ndërkombëtarë për të krijuar së bashku një ambient transparent biznesi, me rregulla të qarta tregu që e bën Shqipërinë një nga vendet më tërheqëse për Investime në Ballkan”

“

Znj. YURI KIM

Ambasadorja e SHBA -ve në Tiranë, Shkëlqësia e Saj



“Ajo që dëgjoj nga populli shqiptar është se ata duan të shohin udhëheqës që punojnë së bashku për hir të popullit. Duan që qeveria t’u ofrojë një mundësi – pa frikë dhe pa korrupsion – një mundësi për të fituar më shumë para, për të arritur një standard të mirë jetese dhe për t’iu dhënë fëmijëve të tyre një të ardhme më të mirë... Populli shqiptar dëshiron rezultate, jo fyerje. Ai do vizion, jo ndarje. Jemi besimplotë se populli dhe udhëheqësit shqiptarë janë të aftë të ngrihen mbi këtë sfidë dhe Shtetet e Bashkuara janë të gatshme, që si gjithmonë, t’ju mbështesin.”

“

Z. EDUARD SHALSI

Ministri i Mbrojtjes së Sipërmarrjes



“Qeveria është fokusuar tek përmirësimi i institucioneve dhe proceseve që merren me trajtimin e kërkesave të biznesit, e në funksion të tyre në ngritjen e rrjetit të koordinatorëve për identifikimin, trajtimin dhe menyrave të zgjidhjes së problematikave të ndryshme të bizneseve. Dixhitalizimi i shërbimeve online dhe procesimi i tyre sipas një sistemi gjurmueshmerie është një dëshmi e qartë e përpjekjeve tona serioze për të ndertuar sisteme të qendrueshëm, për të shmangur burokracitë, vonesat dhe për të rritur cilësinë e komunikimit mes institucioneve shtetërore dhe biznesit”

“

ZNJ. JORIDA TABAKUPërgjegjësjë për Politikat
Ekonomike në Partinë Demokratike

“Rezultatet që u prezantuan tregojnë një situatë të Shqipërisë që nuk është ajo që do të dëshironim. Une flas për të tashmen dhe të ardhmen duke marrë spuntin nga problemet që prezantohen nga

ky raport por dhe të tjera si Doing Business. Të flasësh për biznesin është bërë sfiduese. Nuk e kemi më luksin, as ne dhe as biznesi të humbasim më shumë kohë, më shumë potencial, të humbim 21 për qind të PBB që përfaqëson Dhoma Amerikane e Tregtisë duke mos i dëgjuar këto shqetësime”

Z. MATTEO COLANGELIDrejtori i Bankës Evropiane për
Rindërtim dhe Zhvillim

“EBRD është e interesuar të stimulojmë diskutimin biznes – qeveri mbi çështje që dalin dhe kërkojnë zgjidhje dhe ngritja e Këshillit të Investimeve, është një strukturë për të zhvilluar pikërisht këtyre

dialog. Në qoftë se do të shikojmë në mënyrën se si punojmë për të përmirësuar klimën e investimeve të huaja. Ne besojmë se implementimi i reformës në drejtësi dhe zbatimimi i ligjit, do të sjellin dhe zgjidhje për shumë çështje, si puna e administratës publike, të drejtat e pronës, lufta kundër korrupsionit etj”



Mark Crawford

Aksioner ISB

» Vizion nga faqja 1

...për të mos e bërë këtë. Si rrjedhojë, shqiptarët janë përjashtuar nga pjesëmarrja në ekonomi përmes investimeve pasive. Mungesa e një tregu të kapitalit e ka mbrojtur Shqipërinë nga disa luhajtje globale që kanë ndodhur gjatë dekadave të fundit. Megjithatë, duke marrë parasysh se Shqipëria është në nivelin më të ulët të ekonomive evropiane, të mbrosh investitorët vendas nga një rënie ndërsa janë janë në tokë në zero dhe të ndalosh nëpërmjet kufizimeve ndonjë ngërc ekonomik, nuk është një strategji tërheqëse.

Në përgjithësi, mentaliteti i investimeve shqiptare është ende duke u zhvilluar në drejtim të vlerësimit të rrezikut dhe shpërblimit. Shumica e kompanive janë në pronësi private dhe kur shqiptarët investojnë, shpesh është në bazë të marrëdhënieve personale dhe jo mirëkuptimit të vërtetë të tregut. Si e tillë, shpesh ekziston një ndjenjë e nënkuptuar e garancive personale, rezultateve të sakta dhe kthimeve të garantuara. Kjo është një pamje e papjekur e investimeve, por është e përhapur në vend dhe madje midis disa emigrantëve shqiptaro-amerikanë që kam takuar. Pasi kam notuar kundër rrymës në këtë çështje për disa vjet, kam kuptuar se tregut thjesht do ti duhet më shumë kohë për t'u pjekur, përpara se investimet me bazë kapitalesh, të jenë realisht të mundshme. Në të vërtetë, shqiptarëve duhet t'ju jepen mundësi zgjedhjeje që pasqyrojnë kthime relativisht të parashikueshme në kapital, siç janë pronësitë në shërbime komunale, dhe ato që sigurojnë kthime kontraktuale, siç janë obligacionet.

Duke pasur parasysh këtë realitet, dy gjëra duhet të ndodhin për të ndihmuar zhvillimin e sektorit të tregjeve të kapitalit në Shqipëri.

Së pari. Qeveria duhet të zhvillojë tregjet e kapitalit duke listuar një pakicë aksionesh nga kompani shtetërore si të energjisë elektrike dhe ndërmarrjeve komunale të ujit. Kompanitë e

shërbimeve komunale, siç janë ndërmarrjet komunale të ujit dhe ndërmarrja shtetërore e energjisë, ofrojnë një kthim të parashikueshëm dhe do të jenë tërheqëse jo vetëm për investitorët vendas por dhe ata ndërkombëtarë. Kjo është shtylla e parë e veprimit.

Së dyti, obligacionet e tregtueshme duhet të inkurajohen dhe renditen në tregun ekzistues të këmbimit. Ekzistojnë disa obligacione të korporatave që janë miratuar dhe janë në treg sot, kryesisht të lidhura me institucionet financiare dhe nga ato që lidhen kryesisht me bankat. Këto obligacione janë shumë të rregulluara dhe të emetuara nga sektorët e mbikëqyrtur të ekon-

omisë shqiptare. Ato përshtaten me mentalitetin shqiptar për kthime të parashikueshme dhe duhet të jenë shtylla e dytë e tregjeve të kapitalit.

Qeveria duhet të përfshijë obligacionet si një mekanizëm i shpërndarjes brenda draftit të amnistisë fiskale në mënyrë që të forcojë ekonominë. Projektligji aktual i raportuar thotë se depozitat në para të përfshira në amnistinë fiskale duhet të kalojnë në depozitat bankare komerciale. Kjo është qasje e gabuar. Do të ketë një ndikim të vogël në ekonominë reale. Bankat në Shqipëri janë tashmë likuide dhe një fluksi i ri i likuiditetit, sidomos ai në Lek, mund të ketë një ndikim nominal në uljen e normave të kredidhënies,

TREGJET E KAPITALIT NË SHQIPËRI




por ka më shumë të ngjarë të pasqyrohet në likuiditet të fjetur. Rritjet e depozitave në valutë të fortë do të kenë një ndikim edhe më të keq, duke marrë parasysh që likuiditeti i monedhës së fortë tashmë është mbajtur nën kontroll, herë pas here me norma negative të interesit.


Amnistia fiskale duhet të zbatohet përmes një mekanizmi të Bonove Patriotike. Obligacionet Patriotike shqiptare duhet të jenë të tregtueshme dhe mund të emetohen nga Qeveria ose Pushteti Lokal, për një qëllim specifik. Qëllimet specifike për emetime të Bonove Patriotike mund të përfshijnë rinovimin e një shkolle të dëmtuar nga tërmeti, ose një spitali të ri për të trajtuar sëmundjet infektive. Pavarësisht qëllimit, investimi duhet të jetë specifik dhe lehtësisht i vendosur në ekonomi. Këto forma të Bonove Patriotike duhet të jenë të hapura për të gjithë investitorët. Gjithsesi Bondet duhet të targetojnë pjesëmarrësit në programin e amnistisë fiskale në emetimin fillestar, drejt ofrimit të një kuponi zero përqind, duke i dhënë kështu Qeverisë një burim financiar me kosto zero për periudha të gjata, si psh njëzet vjet. Atëherë, Patriot Bond mund të tregtohet, me gjasë në një treg të orientuar me zbritje, dhe nëse mbajtësit e bonove dëshirojnë, ata mund të fitojnë para nga pozita e tyre duke shitur përmes tregut të kapitalit. Kuponi zero për qind dhe zbritja nëse fitohet paratë e para, do të ishte taksa efektive për mbajtësin e bonove, kostoja e amnistisë fiskale.

Më në fund, Qeveria ka deklaruar se planifikon të legalizojë kanabisin mjekësor në Shqipëri dhe ka qenë duke shqyrtuar legjislacionin gjatë muajit të kaluar. Mund të ketë një tundim për të krijuar një monopol privat ose oligopol në një legalizim të tillë. Një tundim i tillë duhet të refuzohet. Në vend të kësaj, Qeveria duhet të krijojë një model të modeluar sipas përvojës Kanadeze. Duke ndjekur modelin kanadez do të ekzistonte mundësia që subjektet e reja të ekzistojnë në nivelin bashkiak dhe ekzekutiv, që mund të mbrojnë rrjedhjen e ardhshme të parave, emetimin e bonove, të cilat do të tregtohen dhe do të lejojnë publikun e Shqipërisë të marrë pjesë si investitorë. Qeveria më pas do të ridrejtojë këtë situatë aktualisht të paligjshme drejt një situatë produktive, duke sjellë të ardhura të reja dhe mundësi zyrtare të punësimit, si dhe duke siguruar një rrugë për pjesëmarrje më të gjerë financiare publike përmes obligacioneve. Duke përdorur obligacionet, Qeveria do të sigurojë një mjet tjetër me të cilin Tregjet Shqiptare të Kapitalit mund të kenë një fillim. Ky sektor do të tërheqë kapitalin vendas dhe ndërkombëtar dhe është një mënyrë e mirë për ta futur Shqipërinë në hartën e investitorëve.

Ende ka kohë për të zhvilluar tregjet e kapitalit në Shqipëri. Kjo mundësi nuk duhet humbur.



Burimi INSTAT



Burimi INSTAT

COVID 19- ECONOMIC
NEWS

REVISTA MONITOR

Tremujori i parë i vitit i 2020 ka sinjalizuar rënien më të fortë ekonomike që vendi ka përjetuar të paktën në dy dekadat e fundit. Goditja e dyfishtë nga tërmeti i 26 nëntorit dhe izolimi i ekonomisë për shkak të Covid në gjysmën e muajit mars sollën një rezultat negativ në -2.52% në janar-mars 2020. Ky tremujor përfaqëson rënien më të madhe që kur ka nisur të matet PBB tremujore në 2010.

Në baza vjetore, ekonomia e vendit pritet të pësojë rënien më të madhe që nga viti 1997. Sipas parashikimeve të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe Ministrisë së Financave, ekonomia e vendit pritet të pësojë rënie me -5% këtë vit, ndërsa më pesimisti është BERZH me një vlerësim prej -9%. Në tre dekadat e tranzicionit, rënia në nivele negative është regjistruar në vitin 1991 me -29% dhe në vitin 1997 me -10.9%.

Parashikimet mbi rënien ekonomike të këtij viti variojnë nga -5 deri në -9% sipas BERZH, por zgjatja e pandemisë edhe pas qershorit dhe mungesa e parashikimeve të sakta për rikthimin e saj në vjeshtë, e bën po kaq të pasigurt edhe ecurinë e ekonomisë.

Kurba e pandemisë dhe ajo e rikuperimit të ekonomisë po ndjekin njëra-tjetrën, duke sinjalizuar se pandemia do të mbajë peng ekonominë e vendit deri në ikje.

EFEKTET E COVID-19

Ekonomia po shkon drejt rënies më të madhe që nga 1997-a

“**Parashikimet mbi rënien ekonomike të këtij viti variojnë nga -5 deri në -9% sipas BERZH,** por zgjatja e pandemisë edhe pas qershorit dhe mungesa e parashikimeve të sakta për rikthimin e saj në vjeshtë, e bën po kaq të pasigurt edhe ecurinë e ekonomisë.

Në dekadën e parë të tranzicionit, ekonomia shënoi një rënie me 30% në vitin 1991 si pasojë e ndryshimit rrënjësor nga ekonomia e centralizuar në atë të tregut. Mijëra ndërmarrje shtetërore dhe bujqësore në të gjithë vendin u mbyllën teksa, sipërmarrja kaloi në menaxhim të privatëve. Deri në vitin 1997, ekonomia shënoi rritje derisa u godit nga kriza e rëndë financiare që u shkaktua nga firmat piramidale, duke shkaktuar një rënie brenda vitit me -10.9%. Duke qenë se rënia ishte shumë e fortë në vitin

1997, dy vitet që pasuan reflektuan një rritje 8.8% më 1988 dhe 12.9% në vitin 1999 të ndihmuara nga flukset e larta të ndihmave që mori vendi për shkak të krizës së refugjatëve të luftës nga Kosova.

Në dekadën pas vitit 2000, ekonomia e vendit kaloi në një cikël rritës që u nxit nga Investimet e Huaja Direkte dhe një zhvillim i hovshëm i sistemit bankar. Nga viti 2000 deri më 2008 ekonomia e vendit u rrit mesatarisht me 6%, por në periudha të caktuara, u ndikua nga kriza e rëndë energjetike që

pësoi vendi nga mungesa e reshjeve dhe nga krizat e herëpashershme politike.

Me krizën financiare globale të vitit 2008, ekonomia hyri në një cikël të ri, ku përveç krizës disa burime vendase që kishin ushqyer rritjen u maturuan.

Ritmet e rritjes u përgjysmuan nga 2009-2013, me një mesatare rreth 3%. Rrotacioni politik në vitin 2013 e dobësoi më tej ciklin e rritjes, me një rezultat vetëm 1%, që është edhe më i ulët pas krizës financiare deri në vitin 2019.

Nga viti 2013 në vitin 2018, ekonomia shënoi një rritje graduale me ritme mesatare 3%, e nxitur kryesisht nga rritja e eksporteve dhe Investimet e Huaja Direkte në dy projektet e mëdha në gazjellësin TAP dhe në HEC-et e lumit Devoll.

Më përfundimin e këtyre projekteve dhe goditjen që dha tërmeti i 26 nëntorit, ritmet e rritjes u dobësuan duke shënuar rritje me vetëm 2.2% në vitin 2019, teksa 2020 pritet të jetë një njollë të zezë në ciklin e tranzicionit.